



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.16, datë 29.04.2025

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR
SHTETASIN GRAMOS ISLAMLLARI”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29.04.2025, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi I Menaxhimit Strategjik, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” Vendim nr.5, datë 07.02.2025 “Për miratimin e detajimit të fondeve të trashëguara nga viti 2024 në vitin 2025, për Bashkinë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurimin për shtetasin Gramoz Islamllari:

VENDOSI:

1-Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për shtetasin Gramos Islamllari.

2- Vlera prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri shpenzime operative administrate, në programin buxhetor, administrim, planifikim menaxhim.

Vendimi u miratua me 10 Vota pro, vota kundër - s’ka , abstenim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

